

VENDIM
Nr. 28, datë 18.3.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “CARSHOVE” TË SHOQËRISË
“ERMA M.P” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erma M.P” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Carshove”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Carshove”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani